



V E N D I M

Nr. 14 Datë 04. 02 . 2008

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“PROJEKSION ENERGJI” SH.A PËR MODIFIKIMIN E LIÇENSËS PËR AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “PROJEKSION ” SH.P.K**

Në zbatim të nenit 9, nenit 19, pika 1, gërma a; pika 3, dhe 4, të Ligjit Nr. 9072 dt. 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, dhe nenit 15, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 21, dt. 04.04.2007, “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij më dt.04.02.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Projeksion Energji” sh.a për modifikim të liçensës së shoqërisë “Projeksion” sh.p.k për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

V e n d o s i :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a për modifikim të liçensës me Nr. 40, Seria PV06P, leshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 76, dt.07.11.2006 të mbajtur nga shoqëria “Projeksion” shpk për prodhimin e energjisë elektrike
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë shoqërinë në lidhje me Vendimin e ERE-s.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare